



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1420_11_15**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **09.12.2015**

në seancën e mbajtur më datë 28 janar 2016, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit I. S. me shifër DPR- 206662 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1420_11_15** i datës 17.11.2015.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 09.12.2015 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori Ilmi Sinani i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me arsyetimin që të shqyrtohet ankesa e tij edhe njëherë për shkak se shpenzimet e energjisë elektrike që konsumatori shpenzon nuk përputhen me pajisjet teknike që konsumatori ka në këtë pikë matëse.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se me datë 10.06.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS për ndërrim njehsori ka ndalur te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 17720256 me gjendje TL=38060 kWh (traifa e lartë) dhe TU=33483 kWh (tarifa e ulët) dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 63608268 me gjendje TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh, dhe njehsori elektrik i demontuar është dërguar në qendrën e kalibrimit për shqyrtim dhe verifikim.

Me datë 10.07.2014 nga qendra e kalibrimit është lëshuar procesverbali i shqyrtimit të njehsorit elektrik dhe është theksuar se njehsori elektrik nr. 17720256 nuk është brenda kufijve të lejuar.

Me datë 13.10.2014 është lëshuar procesverbali nga qendra e kalibrimit në të cilin theksohet se njehsori elektrik bllobat shtetërore i ka të falsifikuar, nga ana e jashtme njehsorit nuk i vërehen dëmtimet e tjera, në brendi të njehsorit komisioni ka vërejt se numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror.

Me datë 03.12.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS për inspektimin e pikës matëse kanë dal te konsumatori dhe kanë konstatuar gjendjen e kilovatorëve në njehsorin elektrik nr. 63608268, ku sipas të dhënave të përshkruara në procesverbal, gjendja e kilovatëve është TL=006418 kWh, dhe



TU=002900 kWh. Gjithashtu në procesverbalin e KEDS është theksuar se me kërkesë të konsumatorit bllobohet njehsori.

Pas ankesës së konsumatorit, Departamenti për Konsumator në KEDS me datë 05.12.2014 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij me arsyetimin se komisioni nuk ka vërejtur ndonjë element i cili mund të ketë shkaktuar ngarkesë financiare me shumë se sa njehsori i konsumatorit që ka regjistruar, gjithashtu është theksuar se faturimi është bërë konform nenit 2.1 dhe 2.3 të rregullës mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga ana e konsumatorit Ilmi Sinani dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të shkresave të lëndës dhe vendimit të DMK-së ka vërejtur se organi i shkallës së parë ka bërë gjithë analizat e nevojshme të rrjedhës së energjisë së shpenzuar nga konsumatori. Kjo analizë ka përfshi periudhat e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të vjetër elektrik nr. 17720256 nga muaji 08/2002 deri në periudhën 06/2014 ku mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për muaj ka qenë **500.23 kWh/muaj**, apo nëse krahasojmë përqindjen e shpenzimit sipas tarifave, në tarifën e lartë ka shpenzuar mesatarisht 53.20%, ndërsa në tarifën e ulët ka shpenzuar mesatarisht 46.80%. Ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të ri elektrik nr. 636098268 duke nga periudha 07/2014 e tutje mesatarja mujore është **1,222.80 kWh/muaj**, apo nëse krahasojmë përqindjen e shpenzimit sipas tarifave, në tarifën e lartë ka shpenzuar mesatarisht 69.69%, ndërsa në tarifën e ulët ka shpenzuar mesatarisht 30.34%.

Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së pas analizimit të kësaj çështje ka konstatuar se rritja e shpenzimit të energjisë elektrike ka ardhur pasi që konsumatorit i është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik ku konsumatori me njehsorin e vjetër ka pas shpenzimit ma të ulët në krahasim me shpenzimet e energjisë me njehsor të ri. Nga kjo është konstatuar se bazuar në procesverbalin e lëshuar nga qendra e kalibrimit është konstatuar se njehsori elektrik bllobat shtetërore i ka të falsifikuar, nga ana e jashtme njehsorit nuk i vërehen dëmtimet e tjera, në brendi të njehsorit komisioni ka vërejt se numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishitjes së numrave në numëror, mbi këtë bazë mund të konstatojmë se manipulimi i mundshëm i këtij njehsori elektrik ka mund të ketë ndikuar në mos regjistrimin e saktë të shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të vjetër elektrik.

Gjithashtu duhet të theksohet se ndërrimi i njehsorit nga mekanik në njehsor digjital ka bërë edhe që të ndryshoj edhe mënyra e faturimit përveç që ka mund të mënjanohet keqpërdorimi i mundshëm i kësaj pike matëse siç u theksua edhe më lartë ka ndryshuar edhe periudhën e regjistrimit e kilovatëve të shpenzuar sipas sistemit tarifor me tarifë të lartë dhe tarifë të ulët. Andaj krejt këto argumente që u theksuan më lartë janë baza dhe arsye të mjaftueshme që të vërtetojnë faktin se konsumatorit më të drejt i është rritur shpenzimi i energjisë fillimisht duke mënjeluar mundësit e manipulimit dhe tani edhe ndryshimit të periudhës së regjistrimit me tarifë të lartë dhe tarifë të ulët.

Bordi po ashtu ka vlerësuar vendimin e shkallës së parë ku është mbështetur në dispozitat e nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: **“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”**. Andaj mbi bazën e kësaj konsumatori nuk ka ofruar asnjë dëshmi me të cilën do të kundërshtonte shpenzimin e energjisë elektrike të faturuar, andaj si i tillë ka obligim ligjor që të paguaj për atë që shpenzon.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i



drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa dhënë ndonjë arsye konkrete.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Boardi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit I.S.,
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.